

Avokatët i quajnë të padrejta dhe për spektakël bastisjet e Speciales: Po përpiqen ta mbajnë situatën e tensionuar



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



OPOZITA NË KOSOVË VAZHDON TË KËRKOJË ZGJEDHJE TË PARAKOHSHME PARLAMENTARE

OPOZITA INSISTON NË ZGJEDHJE TË REJA: QEVERIA KURTI KA HUMBUR KREDIBILITETIN



Partitë opozitare janë duke insistuar që vendi të shkojë në zgjedhje të parakohshme parlamentare ndonëse nuk i kanë numrat në Kuvend për ta rrëzuar qeverinë Kurti. Përfaqësuesit e opozitës kanë

thënë se qeveria ka dështuar t'i adresojë pritjet e qytetarëve të Kosovës. Sipas tyre, pushteti jo vetëm që ka dështuar në ekonomi, arsim dhe shëndetësi, por edhe në arenën ndërkombëtare. Ndërsa

përfaqësuesit e pushtetit e kanë vlerësuar qesharake kërkesën e opozitës për zgjedhje. Ata kanë kërkuar nga opozita të jetë konstruktive në Kuvend sepse nuk i ka numrat për ta çuar vendin në zgjedhje

PESË LIGJE NË KUSHTETUESE, PUSHTETI AKUZON OPOZITËN SE PO TENTON T'IA BLOKONJË REFORMAT



MASAT NDAJ KOSOVËS VAREN NGA RRJEDHA E DIALOGUT



AKTUALE



SESIONI I 78-të I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË OKB-SË, OSMANI DHE BEGAJ NISEN DREJT NJU-JORKUT

SPECIALJA UA VAZHDON PARABURGIMIN REXHEP SELIMIT DHE JAKUP KRASNIQIT

286 TË IKUR PËR GJASHTË MUAJ, "TË RINJTË PO BËHEN INFERMIERË PËR TË DALË JASHTË VENDIT"

HARADINAJ KËRKON NGA POLICIA TË JETË E PAKOMPROMIS NDAJ ATYRE QË SHKELIN RREGULLAT E KOMUNIKACIONIT


EKONOMI



EKONOMIA E KOSOVËS SHËNON RITJE VETËM 2.02 PËR QIND, OPOZITA AKUZA NDAJ PUSHTËTIT

DYQANET NGATËRROJNË ORIGJINËN E PRODUKTEVE

SPORT



RUMANIA PËRBALLET ME GJASHTË AKUZAT, UEFA NIS HETIMET

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fac: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Tajvani detekton afër 30 avionë luftarakë kinezë rreth ishullit

TAIPEI, 17 SHTATOR - Kina ka fluturuar 28 avionë luftarakë përreth Tajvanit më 17 shtator dhe shumica e tyre kanë kaluar vijën ndarëse në Ngushticën e Tajvanit, thanë autoritetet në Taipei. Sipas autoriteteve, fluturaket kineze kanë kryer misionet të paspecifikuara "me rreze të gjatë veprimi".

Ministria e Mbrojtjes së Tajvanit, ka thënë se 20 avionë janë detektuar mëngjesin e së dielës të cilat kaluan vijën që ndan Tajvanin nga Kina dhe hynë në zonën e identifikimit të mbrojtjes ajrore të ishullit vetëqeverisës. Sipas Tajvanit, fluturaket hynë në pjesën

juglindore të ishullit.

Kina ka kryer "misione sikurse stërvitjet me rreze të gjatë veprimi", ka thënë Ministria e Mbrojtjes përmes një deklarate, duke shtuar se është duke monitoruar situatën përmes avionëve dhe anijeve patrulluese.

Pekini pretendon se Tajvani është pjesë e territorit të tij dhe një ditë do ta marrë nën kontroll, qoftë edhe duke përdorur forcën nëse është e nevojshme. Kina ka rritur aktivitetin ushtarak dhe presionin diplomatik ndaj ishullit viteve të fundit, përdërisa raportet mes Taipei

dhe Pekinit janë përkeqësuar.

Javën e kaluar, Taipei ka raportuar për rritje të numrit të inkursioneve të avionëve luftarakë dhe anijeve kineze, përdërisa Pekini tha se forcat e saj ishin vënë "në gatishmëri të lartë", pasi dy anije të Shteteve të Bashkuara dhe Kanadasë kaluan transit gjatë këtij muaji përmes Ngushticës së Tajvanit. Ministria e Mbrojtjes së Tajvanit, ka njoftuar se 68 avionë kinezë dhe dhjetë anije ishin detektuar përreth ishullit të mërkurën dhe të enjten.

Disa nga avionët dhe luftanijet ishin nisur drejt një zone të paspecifikuar në Paqësorin

Perëndimor "për të kryer stërvitje detare dhe ajrore". Në këto stërvitje kishte marrë pjesë edhe avionmbajtësja kineze, Shandong, ka thënë ministria. Shandong, një prej dy avionmbajtësive aktive në flotën kineze është detektuar të hënën rreth 110 kilometra në juglindje të Tajvanit, duke u nisur drejt Paqësorit Perëndimor, kanë thënë autoritetet në Taipei. Kina nuk ka komentuar lidhur me mbajtjen e ndonjë stërvitjeje në Paqësorin Perëndimor.

Në prill, Pekini kreu stërvitje ushtarake që simulonin



rrethimin e ishullit, pasi presidentja e Tajvanit, Tsai Ing-wen, u takua në Kaliforni me kryetarin e Dhomës së Përfaqësuesve, Kevin McCarthy. Atëbotë, Tajvani detektoi 71 avionë luftarakë kinezë brenda 24 orëve, që është numri më i lartë i avionëve që ishulli ka detektuar brenda një dite që nga dhjetori i vitit 2022.

Sondazhi i "Reuters"-it dhe "Ipsos"-it: Bideni dhe Trumpi, të barabartë në garën presidenciale

WASHINGTON, 17 SHTATOR - Shanset e presidentit amerikan Joe Biden për t'u rrizgjedhur në këtë post kërcënohen nga shqetësimet e votuesve për moshën e tij, ekonominë dhe krimin, duke i dhënë kundërshtarit republikan Donald Trump një shans për t'u rikthyer në Shtëpinë e Bardhë, ka treguar një sondazh i "Reuters"-it dhe "Ipsos"-it.

Një sondazh i opinionit publik ka treguar se 80-vjeçari Biden aktualisht është i lidhur me Trumpin trevjeçar më të ri, i cili është kandidati më i madh për nominimin republikan, pasi të dy kanë mbështetjen e 39 për qind të votuesve, me një në pesë të pavendosur.

Bideni ka një avantazh të qartë në mes të votuesve që janë më të shqetësuar për mbrojtjen e të drejtave të abortit, ndërsa Trumpi mbështetet nga ata që janë të shqetësuar për krimin, tregoi sondazhi.

Rezultoni se Trumpi është ende shumë "i gjallë" politikisht, pavarësisht një sërë akuzash federale dhe shtetërore për krime të shumta. Ai pritet të kalojë pjesën më të madhe të vitit të ardhshëm në sallat e gjyqit gjatë fushatës.

Lajmi i keq për Biden është se Trumpi ka një avantazh në shtatë shtetet ku zgjedhjet presidenciale të 2020 ishin më të pasigurt, përkatësisht Gjeorgjia, Arizona,



Wisconsin, Pensilvania, Karolina e Veriut, Nevada dhe Michigan. Në ato shtete, Trump tani mbështetet nga 41 për qind e votuesve, gjashtë për qind më

shumë se Biden dhe 24 për qind janë të pavendosur.

Biden gjithashtu përballet me rrezikun e humbjes së votuesve të pavarur, të cilët i sollën fitoren tre

vjet më parë. Nëse zgjedhjet do të mbaheshin tani, Trumpi do të mbështetej nga 32 për qind e votuesve të pavarur dhe Bideni nga 30 për qind, tregoi sondazhi. Votuesit shprehën shqetësim për moshën dhe aftësinë e Bidenit për të shërbyer si president, me 77 për qind të të anketuarve, përfshirë 65 për qind të demokratëve, duke thënë se ai është shumë i vjetër për të qenë president, ndërsa 56 për qind kanë thënë se Trumpi është shumë i vjetër për të qenë president.

Sondazhi është kryer online në të gjithë vendin nga data 8 deri më 14 shtator dhe devijimet e mundshme janë plus ose minus dy për qind.

Rusia dhe Ukraina përballen në GjND për rastin e gjenocidit

HAGË, 17 SHTATOR - Rusia dhe Ukraina do të përballen sot (e hënë) para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GjND) në rastin që ka në qendër pretendimet e Moskës se pushtimi i saj i Ukrainës është bërë për të parandaluar një gjenocid.

Ukraina e ka sjellë këtë rast në gjykatën më të lartë të Kombeve të Bashkuara disa ditë pasi ka nisur pushtimi rus më 24 shkurt të vitit të kaluar. Kievi ka argumentuar se Rusia po shkel ligjin ndërkombëtar duke thënë



se pushtimi justifikohet me gjenocidin e pretenduar në lindje

të Ukrainës.

Zyrtarët rusë vazhdojnë ta akuzojnë Ukrainën se po kryen gjenocid.

Rusia dëshiron që rasti të hidhet poshtë dhe kundërshton juridiksionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Seanca dëgjimore, që do të zgjasë deri më 27 shtator, do të përqendrohet në themelet e çështjes në vend se në argumentet ligjore lidhur me juridiksionin e gjykatës.

Moska ka thënë se Ukraina po e përdor këtë rast për të fituar një

vendim gjyqësor lidhur me ligjshmërinë e veprimit ushtarak të Rusisë. Ukraina veçse e ka një fitore pasi gjykata marsin e vitit të kaluar ishte në favor të saj gjatë vendimit preliminar. Bazuar në atë vendim, gjykata urdhëroi Rusinë që të ndalë menjëherë veprimet ushtarake në Ukrainë. Në seancën dëgjimore do të ketë dëshmi nga 32 shtete të tjera dhe të gjitha do të mbështesin argumentin e Ukrainës se gjykata ka juridiksion për të vazhduar me këtë rast.

Përdërisa Rusia ka injoruar

urdrin e gjykatës që të ndalë veprimet ushtarake dhe kjo gjykatë nuk ka mënyrë që të zbatojë vendimet e saj, ekspertët kanë thënë se një vendim eventual në favor të Ukrainës do të ishte i rëndësishëm në pretendimet në të ardhmen për dëmshpërblim. Konventa për gjenocid e Kombeve të Bashkuara e vitit 1948 e përkufizon gjenocidin si krime të kryera "me qëllim për të shkatërruar, të gjithin apo një pjesë, një komb, një etni, një racë apo një grup fetar".

Stoltenbergu: Ukraina një ditë do t'i bashkohet NATO-s

BRUKSEL, 17 SHTATOR - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, nuk ka parashikuar një përfundim të shpejtë të luftës në Ukrainë. Stoltenbergu në një intervistë për "Funke" ka thënë se

"shumica e luftërave zgjasin më tepër sesa që pritet fillimisht". "Ne të gjithë urojmë që të ketë paqe sa më shpejtë. Por, në të njëjtën kohë, duhet ta pranojmë: nëse presidenti Zelensky dhe ukrainasit

ndalojnë së luftuari, atëherë shteti i tyre më nuk do të ekzistojë. Nëse presidenti Putin dhe Rusia ulin armët, atëherë do të kemi paqe", ka thënë Stoltenbergu. Ai ka shtuar se është i bindur që një

ditë Ukraina do t'i bashkohet NATO-s. "Nuk ka dyshim se Ukraina do të jetë dikur në NATO", ka thënë Stoltenbergu. Në anën tjetër, shefi i NATO-s i ka bërë thirrje Gjermanisë që ta rrisë buxhetin për mbrojtje.



Sesioni i 78 i Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, Osmani dhe Begaj nisen drejt Nju-Jorkut

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka udhëtuar për në Nju-Jork, ku në kuadër të sesionit të 78-të të Asamblesë së Përgjithshme (AP) të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), do të zhvillojë takime me liderë botërorë dhe organizata ndërkombëtare. Sipas njoftimit të zyrës së presidentes, Osmani është ftuar së bashku me Zotërinë e Parë, Prindon Sadriu, që të marrin pjesë në pritjen zyrtare të organizuar nga presidenti i ShBA-së, Joe Biden. Ndërsa Zotëria e Parë gjithashtu është ftuar të marrë pjesë në një pritje të veçantë të organizuar nga Zonja e Parë e ShBA-së, Jill Biden.

“Përgjatë kësaj vizite, presidentja në takime me homologët e saj do të flasë për zhvillimet e fundit në Kosovë, sikurse edhe për synimet e Kosovës për krijimin e raporteve me shtetet anëtare të OKB-së dhe anëtarësim në organizata ndërkombëtare. Ajo, po ashtu, do të marrë pjesë edhe në aktivitete e diskutime të shumta të organizuara nga shtetet aleate. Përveç takimeve,

presidentja do të mbajë diskutime në disa nga universitetet dhe institucionet më prestigjioze në ShBA”, ka njoftuar presidenca.

Në agjendën e presidentes Osmani do të jenë edhe një sërë aktivitete të përbashkëta me mërgatën shqiptare në Amerikë si dhe disa nga shoqatat të cilat e zhvillojnë aktivitetet në ShBA.

Edhe presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, është nisur të dielën për në Nju-Jork të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA). Ai do ta kryesojë delegacionin shtetëror të Shqipërisë që do të marrë pjesë në sesionin e 78-të të Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB).

Së bashku me kryetarët e shteteve/qeeverive të 193 vendeve anëtare të OKB-së, Begaj do të mbajë fjalën, në cilësi kombëtare, në debatin e përgjithshëm të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. Gjithashtu, ai do të marrë pjesë në Forumin e nivelit të lartë politik për zhvillimin e qëndrueshëm, i cili do të



mbahet në Nju-Jork, në vigjilje të sesionit të 78-të të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. Edhe në këtë forum presidenti Begaj do ta mbajë fjalën, në emër të Shqipërisë, në segmentin e

dedikuar të dialogut të udhëheqësve, përkrah kryetarëve të delegacioneve zyrtare të vendeve të tjera. Begaj gjatë periudhës së qëndrimit në Nju-Jork do të

zhvillojë edhe takime dypalëshe me krerë të tjerë shtetesh dhe zyrtarë të lartë amerikanë, por edhe me përfaqësues të shoqatave të diasporës shqiptare në ShBA.

Pesë ligje në Kushtetuese, pushteti akuzon opozitën se po tenton t'ia bllokojë reformat

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Qeveria e Kosovës dhe mazhoranca në Kuvend është duke u akuzuar për miratim të ligjeve që janë në kundërshtim me Kushtetutën e vendit. Sipas Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), ekzekutivi është shndërruar në shkelësin më të madh të Kushtetutës, ndërkaq në Institutin e Kosovës për Drejtësi (IKD) thonë se në përmbajtjen e ligjeve të sponsorizuara nga qeveria ka probleme serioze kushtetuese. Në anën tjetër, në partinë në pushtet e kanë kritikuar opozitën se është duke e përdorur mekanizmin e Gjykatës Kushtetuese për t'i bllokuar reformat që po i ndërmerren qeveria. Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, ka thënë për “Kosovapress” se opozita është duke e fituar çdo betejë me pushtetin në Gjykatën Kushtetuese. Ai ka përmendur rrëzimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial dhe Ligjin për Zyratë Publikë, të cilët, sipas tij, dëshmojnë padijeninë dhe dëmin e vazhdueshëm që qeveria po ia bën Kosovës.

“E kemi të qartë tashmë se sa betejat si opozitë i kemi fituar në raport me këta njerëz të padijshëm në Gjykatën Kushtetuese. Këta janë edhe të padijshëm edhe të dëmshëm. Të

bësh një veprim të tillë që cenon direkt pavarësinë e nivelit lokal të komunave duhet me qenë, ose i marrë, ose shumë i padijshëm. Pasi ta bësh me vetëdije një veprim të tillë i cili është jokushtetues atëherë s'ka si të jetë ndryshe veçse me qenë i marrë. Nëse e kanë bërë pa vetëdije këta janë të padijshëm pasi gjërat bazike që duhet me i ditë një qeveri, këta nuk po i dinë”, ka thënë Tahiri.

Sipas tij, edhe Ligji për Tatimin në Pronë është antikushtetues dhe, si i tillë, do të rrëzohet nga ky institucion.

Ndërsa hulumtuesi në Institutin e Kosovës për Drejtësi (IKD), Naim Jakaj, ka thënë se kjo legjislaturë në Kuvend ka më së shumti ligje të dërguara në Gjykatën Kushtetuese. Ai ka theksuar se Qeveria e Kosovës nuk është duke draftuar ligje në pajtim me Kushtetutën dhe standardet ndërkombëtare. “Kjo legjislaturë ka ligje më së shumti të dërguara në Gjykatën Kushtetuese dhe ligje që më së shumti i ka rrëzuar Gjykata Kushtetuese... Sa i përket përmbajtjes se si është duke shkruar qeveria në raportet e IKD-së ne kemi evidentuar probleme kushtetuese të shkrimit të këtyre ligjeve”, ka thënë Jakaj.

Por të kundërtën e ka thënë



deputeti i Vetëvendosjes, Adnan Rrustemi, i cili njëherësh është edhe kryetar i Komisionit për Legjislacion në Kuvend. Ai ka kritikuar partitë opozitare se po tentojnë përmes mekanizmit të Gjykatës Kushtetuese t'i bllokojnë reformat e iniciuara nga qeveria Kurti. “Motivi i opozitës është në dy pika, e para për të vonuar reforma të caktuara të qeverisë. Dërgimi në Gjykatën Kushtetuese po merr një periudhë të gjatë të shqyrtimit, eventualisht

aktgjykimin përfundimtar mbi përputhshmërinë e një ligji me Kushtetutën e Kosovës. Në rrafshin e parë po synojnë të vështirësojnë qeverisjen duke i vonuar reformat. Motivi i dytë është krejtësisht inkriminues do të thosha unë në kuptimin e mbrojtjes së interesave individuale dhe grupe që kanë”, ka thënë Rrustemi.

Aktualisht në Gjykatën Kushtetuese janë duke u shqyrtuar Ligji për Paga në Sektorin Publik,

Ligji për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, Ligji për Masat e Përkohshme të Produkteve Themelore në raste të veçanta të destabilizimit në treg, Ligji për Pagën Minimale dhe Ligji për Tatimin në Pronë. Gjykata Kushtetuese muaj më parë ka rrëzuar Ligjin për Këshillin Prokurorial, derisa së fundmi shfuqizoi disa nene të rëndësishme të Ligjit për Zyratë Publikë.



OPOZITA NË KOSOVË VAZHDON TË KËRKOJË ZGJEDHJE TË PARAKOHSHME PARLAMENTARE

Opozita insiston në zgjedhje të reja: Qeveria Kurti ka humbur kredibilitetin

Partitë opozitare janë duke insistuar që vendi të shkojë në zgjedhje të parakohshme parlamentare ndonëse nuk i kanë numrat në Kuvend për ta rrëzuar qeverinë Kurti. Përfaqësuesit e opozitës kanë thënë se qeveria ka dështuar t'i adresojë pritjet e qytetarëve të Kosovës. Sipas tyre, pushteti jo vetëm që ka dështuar në ekonomi, arsim dhe shëndetësi, por edhe në arenën ndërkombëtare. Ndërsa përfaqësuesit e pushtetit e kanë vlerësuar qesharake kërkesën e opozitës për zgjedhje. Ata kanë kërkuar nga opozita të jetë konstruktive në Kuvend, sepse nuk i ka numrat për ta çuar vendin në zgjedhje

**EPOKA
ERE**

Lirim GECI

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Edhe pse nuk i kanë numrat për ta rrëzuar qeverinë Kurti në Kuvendin e Kosovës, partitë opozitare janë duke kërkuar që vendi të shkojë në zgjedhje të parakohshme parlamentare. Kjo kërkesë e opozitës nuk është duke u përfillur nga partia në pushtet - Lëvizja Vetëvendosje, e cila është shprehur e bindur se do ta çojë deri në fund mandatin qeverisës. Përfaqësuesit e tri partive opozitare, PDK-së, LDK-së, AAK-së, në vazhdimësi janë duke kërkuar që Kosova të shkojë në zgjedhje, me arsyetimin se qeveria Kurti ka dështuar në të gjitha fushat, duke përfshirë ekonominë, shëndetësinë,

arsimin etj. Po ashtu, opozita është shprehur mjaft kritike edhe në raport me procesin e dialogut me Serbinë dhe raportet e tendosura në mes të qeverisë Kurti me bashkësinë ndërkombëtare, konkretisht me Bashkimin Evropian dhe ShBA-në, të cilat kanë vendosur masa ndaj Kosovës për shkak të situatës së krijuar në veri. Para disa ditësh lideri i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se qeveria Kurti e ka humbur legjitimitetin. Ai ka vlerësuar se është e domosdoshme të mbahen zgjedhjet e reja. "Kjo qeveri tashmë e ka humbur çdo kredibilitet dhe nevoja për t'u rikthyer te qytetarët, përmes zgjedhjeve të parakohshme, është e domosdoshme", ka thënë Krasniqi. Po ashtu, Krasniqi ka

kritikuar kryeministrin Albin Kurti për dialogun me Serbinë, duke iu referuar takimit të 14 shtatorit në Bruksel. "Atë që ia kemi thënë shumë herë kryeministrit Kurti, ai tek sot e paska kuptuar. Më 27 shkurt në Bruksel dhe më 18 mars në Ohër, kryeministri Kurti ka pranuar një marrëveshje dhe një aneks të zbatimit të saj, përmes të cilave ka hequr dorë nga njohja e ndërsjellë, ndërsa ka vendosur asociacionin dhe autonominë politike për serbët në qendër të dialogut.

Në këtë situatë - të qëndrimit refuzues si pasojë e pranimit paraprak, kryeministri Kurti e ka futur veten. Askush nuk e ka detyruar ta pranojë marrëveshjen dhe aneksin e saj të zbatimit, nëse ka qenë i bindur se ato janë të dëmshme. Tash, pasi e ka kuptuar se ka gabuar, ka vendosur të bëjë lojëra fjalësh dhe hapa mbrapa. Fatkeqësisht, ky ndryshim i qëndrimit nuk do t'i kushtojë atij, por Kosovës. Kosova dhe qytetarët e saj nuk i kanë borxh asgjë kryeministrit Kurti, aq më pak sanksionet të cilat tashmë po i vuajmë dhe të tjera që janë paralajmëruar", ka thënë Krasniqi.

Ai ka thënë se thirrjet populiste për t'u bashkuar kundër Perëndimit dhe botës demokratike në një shtet që ka synim integrimin euroatlantik janë çmenduri e llojit të vet. Në

këtë kontekst, ai ka thënë se Kosovës i duhet një qeveri kredibile, e cila e rikthen vendin në rrugën euroatlantike. "Qytetarëve dhe shtetit tonë nuk i duhet e nuk i ndihmon ky kurs i konfrontimit me aleatët strategjikë. Sot, para së gjithash, Kosova ka nevojë për një qeveri tjetër - kredibile, të aftë dhe të përgjegjshme, e cila e rikthen vendin në kursin e nevojshëm të zhvillimit dhe integritimit euroatlantik", ka thënë Krasniqi. Ndërsa shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Arben Gashi, ka deklaruar se opozita nuk i ka numrat e nevojshëm për ta rrëzuar qeverinë Kurti. Po ashtu, Gashi ka thënë se as qeveria s'i ka numrat për të qeverisur. Sipas tij, për t'i kaluar ligjet, qeverisë po i duhet mobilizim disa javë. "Ne jemi në një situatë kur duhet të flasim dhe të jemi të sinqertë me qytetarët e Kosovës dhe me veten tonë. E vërteta është që nuk kemi numra për ta rrëzuar qeverinë. Po ashtu, është e vërtetë se qeveria nuk i ka numrat të qeverisë. Pra jemi në një situatë bllokade, ku qeverisë për të kaluar ligje i duhet një mobilizim i jashtëzakonshëm disajavësh që t'i detyrojë deputetët dhe mezi i mbërrin 61 deputetë që të mund t'i kalojë disa ligje, pastaj për muaj të tërë nuk kalon asgjë. Pothuajse krejt viti 2023 karakterizohet me këtë situatë,

ku ka një vështirësi të theksuar të kalimit të ligjeve apo mbajtjes së seancave në Kuvendin e Republikës", ka thënë Gashi në një intervistë në "ATV".

Pavarësisht prej kësaj, ai ka thënë pozita dhe opozita duhet të merren vesh për zgjedhjet e reja të cilat, sipas tij, nëse nuk mbahen sivjet, do të mbahen vitin e ardhshëm. Në anën tjetër, iniciuesi i mocionit për rrëzimin e qeverisë Kurti, lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, pas dështimit të takimit të së enjtes në Bruksel, ka kërkuar nga kryeministrit Albin Kurti të japë dorëheqje. "Këtë veprim duhet ta bëjë edhe nëse ai mendon se është në rrugë të drejtë. Ai obligohet ta pyesë popullin se çka mendon për veprimet e tij. Në demokraci zgjedhjet janë përgjigja më e mirë", ka shkruar Haradinaj në "Facebook". Më tutje, ai ka thënë se në rast të mungesës së reflektimit të Kurtit, përgjegjësia mbetet te liderët e tjerë politikë, që të bashkohen dhe të veprojnë urgjentisht për ta dërguar vendin në zgjedhje, duke e shkarkuar Kurtin përmes mocionit. "Është koha ta pyesim popullin se si të dalim nga kjo gjendje e rrezikshme", ka shkruar Haradinaj.

Thirrjet e opozitës për zgjedhje të reja janë duke u injoruar nga pushteti. Ata janë shprehur të bindur se opozita nuk i ka

Masat ndaj Kosovës varen nga rrjedha e dialogut

BRUKSEL, 17 SHTATOR - Masat ndëshkuese që Bashkimi Evropian (BE) ka vendosur ndaj Kosovës në korrik mund të hiqen ose shtohen, por kjo varet nga rrjedha e situatës në terren dhe dialogu për normalizimin e raporteve me Serbinë, kështu i ka thënë “Radios Evropa e Lirë” një burim në Bruksel, që shtoi se për çështjen e masave, shefi i diplomacisë së BE-së, Josep Borrell, ka diskutuar me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, gjatë raundit të fundit të dialogut më 14 shtator.

Sipas burimit, Borrelli i ka thënë Kurtit se është i gatshëm ta rekomandojë heqjen e masave nëse do të raportonte për sukses në takim. Por, raundi i dialogut dështoi pa një ujudi pasi, siç ka thënë, Kosova nuk pranoi një propozim të BE-së për marrëveshjen për normalizim, andaj nuk pati edhe lëvizje sa i përket masave.

Zyrtari i BE-së i ka thënë “REL”-it se masat ndaj Kosovës janë të përkohshme, mund të hiqen, por edhe të shtohen, pasi për to janë pajtuar 27 shtetet anëtare të bllokut të cilat nuk i vënë në dyshim masat.

Qeveria e Kosovës ishte njoftuar për masat e BE-së më 28 qershor dhe ato hynë në fillim të korrikut. Ato ishin vendosur për shkak të mospërmbushjes së kushteve të BE-së dhe Shteteve të Bashkuara për shtensionimin e situatës në veri të Kosovës. Tensionet në këtë zonë të banuar me shumicë serbe u rritën në fund të majit.

Masat ndëshkuese përfshijnë: suspendimin e përkohshëm të punës së trupave të krijuara në bazë të Marrëveshjes së Stabilizim

Asociimit, mosftesën e Kosovës në takime të nivelit të lartë dhe suspendimin e vizitave bilaterale, përveç atyre që fokusohen në adresimin e krizës në veri të Kosovës në kuadër të kornizës së dialogut të lehtësuar nga BE-ja.

Po ashtu, masat përfshijnë edhe ndaljen e programimit të fondeve për Kosovën nga IPA 2024 (Instrumentet e Para-Anëtarësimit). Propozimet e Kosovës në kuadër të Kornizës së Investimeve në Ballkanin Perëndimor nuk janë dorëzuar për shqyrtim nga bordi më 29 dhe 30 qershor.

Pas takimit në kuadër të dialogut më 14 shtator, nga deklarata e përfaqësuesit të lartë të BE-së për politikë të jashtme dhe siguri, Josep Borrell, ishte e dukshme se lehtësuesit e këtij procesi nuk mendojnë se janë përmbushur kushtet për heqjen e masave ndëshkuese ndaj Kosovës, pasi Borrelli deklaroi se masat që i ka ndërmarrë Kosova për shtensionimin e situatës në veri, ndonëse mirëpritën nga blloku, nuk mjaftojnë dhe nuk janë në përputhje me kërkesat dhe pritjet e BE-së.

Kosova dhe BE-ja në korrik u pajtuan për disa hapa që synojnë shtensionimin e situatës në veri. Që atëherë, Prishtina ka thënë se ka reduktuar praninë policore në dhe përreth ndërtesave komunale në veri të Kosovës. Po ashtu, është hartuar edhe një udhëzim administrativ që mundëson largimin e kryetarëve të komunave përmes një peticioni. Këto hapa të ndërmarra nga Kosova në BE janë vlerësuar si “veprime në drejtim të duhur”, por jo të mjaftueshme sepse, sipas një diplomati me të



cilin bisedoi REL-i, ato “nuk janë as të menjëhershme, as të mjaftueshme dhe nuk janë tërësisht në përputhje me kërkesat” e bllokut evropian.

Pas takimit të 14 shtatorit, i dërguari i posaçëm i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajčak, të enjten mbrëma i ka njoftuar ambasadorët e shteteve anëtare në Komitetin për Politikë dhe Siguri të BE-së për bisedime. Ndonëse aty, sipas burimeve diplomatike, është përsëritur thirrja për “një qasje të balancuar kur janë në pyetje masat”, Lajčaku ka marrë mbështetjen për punën e tij dhe, sipas të njëjtave burime, “askush nuk ka vënë në dyshim masat ndaj Kosovës”. Ambasadorët kanë kërkuar që masa të tilla të shqyrtohen edhe për Serbinë sepse ka shumë shtete që besojnë se Kosova nuk është e vetnja fajtoare për tensionet në veri.

Burimet në BE kanë thënë se shtetet e bllokut “po monitorojnë edhe sjelljen e Serbisë” dhe se “lehtësuesit do të preferonin sikur të mos kishte fare masa ndaj asnjërës palë”.

Në BE për një kohë përmendin sanksionimin e Serbisë si “një

mundësi”, por deri më tani masa janë vendosur vetëm ndaj Kosovës. Kosova për veprimet apo mosveprimet e saj sa i përket situatës në veri është qortuar edhe publikisht, ndërkaq Serbia është qortuar në takime të mbyllura, por jo edhe publikisht. Tensionet në veri të Kosovës u rritën në maj, pasi kryetarët e rinj shqiptarë të zgjedhur në prill – në votimet e bojkotuar nga serbët lokalë – hynë në ndërtesat komunale me asistimin e Policisë së Kosovës. BE-ja dhe ShBA-ja vazhdimisht kanë kërkuar nga Kosova dhe Serbia t'i ulin tensionet dhe që në katër komunat veriore të mbahen zgjedhje të reja.

Ndërsa gjatë këtij viti Kosova dhe Serbia kanë arritur gojarisht Marrëveshjen drejt Normalizimit dhe Aneksin për zbatimin e saj, por blloku evropian ka thënë se zbatimi i saj nuk ka nisur. Marrëveshja prej 11 nenesh nuk përfshin njohjen reciproke për të cilën insiston Kosova, por kërkon nga Kosova dhe Serbia t'i pranojnë dokumentet dhe simbolet e njëra-tjetrës, përfshirë: pasaportat, diplomatat dhe targat. Po ashtu, palët zotohen se do t'i zbatojnë

marrëveshjet e arritura më herët në procesin e dialogut. Pas përfundimit të raundit të fundit të dialogut në nivel të lartë në Bruksel, Borrelli ka deklaruar se “të dyja palët janë në shkelje serioze të obligimeve të tyre nga marrëveshja e dialogut”.

Në pyetjet se pse atëherë vetëm njëra palë, në këtë rast Kosova, është duke u përballur me masa ndëshkuese e Serbia jo, një zyrtar i BE-së ka thënë se “masat janë specifike dhe kanë të bëjnë ekskluzivisht me hapat për shtensionimin e situatës në veri” të Kosovës. “Vendet anëtare po monitorojnë edhe sjelljen e Serbisë. Serbia nuk ka bërë asgjë për t'i zbatuar obligimet e saj nga marrëveshja. Ka mundur të bëjë shumë gjëra në mënyrë të njëanshme si, për shembull, sa i përket njohjes së dokumenteve. Nuk ka pasur nga ana e Serbisë as masa, as dënim të njerëzve përgjegjës për dhunën në veri të Kosovës, edhe pse identiteti i tyre është i njohur”, tha një zyrtar i BE-së, i cili shtoi se mund të jetë e gjatë lista e gjërave që nuk ka bërë Serbia. Megjithatë, ky zyrtar tha se “duhet së pari Kosova ta nisë procedurën për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, pasi është një proces i gjatë dhe ne pastaj do të siguronim që Serbia t'i kryejë detyrat e veta”. Se cili do të jetë fati i masave ndaj Kosovës, nëse ato do të hiqen apo do të shtohen masa të reja, apo nëse do të vendosen masa ndaj Serbisë, pritet të merret vendim në javët në vijim pasi të zhvillohen konsultimet mes shteteve anëtare të BE-së dhe pas konsultimeve në mes të BE-së dhe ShBA-së.

Kërkesa për zgjedhje të reja, analistët: Opozita po synon rritjen e elektoratit

Thirrjet e partive opozitare për të shkuar në zgjedhje të parakohshme, njohësit e çështjeve politike janë duke i vlerësuar si thirrje për rritjen e elektoratit të tyre. Sipas tyre, opozita e di mirë që nuk mund ta dërgojë vendin në zgjedhje pasi nuk i ka votat e mjaftueshme. Ata kanë thënë se vendi mund të shkojë në zgjedhje vetëm nëse qeveria Kurti jep dorëheqje por, sipas tyre, për këtë gjasat janë shumë të vogla. Analisti politik Shemi Jashari ka thënë “Ekonomia Online” se kërkesat e

opozitës për zgjedhje janë normale pasi, sipas tij, sa më shumë që zgjatë qeveria e tanishme, aq më lehtë do të jetë për opozitën sepse do të ketë argumente më shumë për t'i bindur qytetarët kundër saj. “Kërkesat nga opozita për të shkuar në zgjedhje për shkarkim të qeverisë në demokraci janë minimale. Secila opozitë normalisht do të duhej ta kërkonte shkarkimin e një qeverie që është në pozitë për të organizuar zgjedhje. Sa më shumë që zgjatë kjo qeveri aq më

lehtë do të jetë për opozitën sepse do të ketë argumente më shumë për ta bindur qytetarin se kjo qeverisje nuk është e mirë. Skandalet e njëpasnjëshme që është duke i prodhuar ka bërë që opozitës t'i japë kuroja që të dalë nga ai pozicion inferior që ka ekzistuar tek opozita në dy vitet e para të qeverisjes dhe tash sikur duket që kanë marrë më shumë guxim për të kërkuar zgjedhje”, ka thënë Jashari. Ai ka thënë se sulmet që qeveria është duke i bërë në adresë të gjyqësorit dhe prokurorisë kanë

bërë që një numër i madh i qytetarëve ta shikojnë pozicionin e vet kur të organizohen zgjedhjet. Ndërsa analisti tjetër politik, Arbnor Sadiku, ka thënë se duke u bazuar në numrat që ka partia në pushtet, gjasat për të shkuar në zgjedhje janë shumë të vogla. Sipas tij, thirrjet e partive opozitare për të shkuar në zgjedhje janë duke u bërë për arsye që në zgjedhjet e ardhshme të dalin të dytat dhe të bashkëqeverisin me LV-në. “Bazuar në numrin e deputetëve që ka LV-ja në Kuvend, gjasat për

të rënë kjo qeveri shumë shpejt janë jashtëzakonisht të vogla. Natyrisht që opozita nuk ka tjetër punë përveç që ta dërgojë vendin në zgjedhje në çdo kohë dhe në çdo moment pasi që pret një momentum më të mirë. Ndoshta jo që praktikisht të dalë të parat, por si e dyta apo e treta parti të ketë një rezultat më të favorshëm në zgjedhjet e ardhshme, me një LV e cila mund t'i ketë nën 40 për qind të elektoratit të Kosovës dhe nuk do të mund ta krijojë qeverinë e re pa ndonjë parti opozitare”, ka thënë Sadiku.

numrat për ta rrëzuar qeverinë Kurti në Kuvendin e Kosovës. Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Agon Batusha, në një prononcim për “Blic”-in, ka thënë se opozita është bërë qesharake në raport me kërkesën për zgjedhje. Ai e ka porositur opozitën se nëse i ka votat, le ta sjellë mocionin në Kuvend ose në të kundërtën të

punojë. “Këto komente apo këto pretendime të opozitës janë prej 14 shkurtit e tutje. Nuk ka ndodhur të fillojë një sezon parlamentar e as ka përfunduar pa deklarime të tilla të opozitës, të cilat janë bërë qesharake. Pra vetë opozita po bëhet qesharake me këto deklarata. Nëse i ka votat, le ta sjellë mocionin, le ta

provtojë. Nëse nuk i ka, mos t'i terrorizojnë qytetarët me deklarata të tilla, por le të vijë të punojë. Është koha të punohet, në komisione, në ligje sepse ligjet nuk janë për qeverinë, por për qytetarët e Kosovës. Kemi nevojë t'i përmirësojmë reformat për të cilat edhe BE-ja na i kërkon, edhe raportet e tjera

të auditorit etj., që tregojnë se duhen disa reforma. Hajde t'i bëjmë reformat e jo deklarata të tilla. Nëse i kanë votat, të shkojmë në zgjedhje. Nëse nuk i kanë, të punojnë”, ka thënë Batusha.

Vendi mund të shkojë në zgjedhje nëse 61 deputetë të Kuvendit votojnë në favor të

mocionit të mosbesimit ndaj qeverisë. Aktualisht opozita ka mbi 40 deputetë dhe pa mbështetjen e deputetëve të pushtetit nuk mund të kalojë mocionin kundër qeverisë Kurti. Ajo çfarë mund të bëjë opozita me këta numra është vetëm ta iniciojë mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë.

Abdixhiku për zgjedhjet e brendshme në Prishtinë: Forcë prijëse për shumë vjet

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka komentuar proceset zgjedhore nëpër degë të kësaj partie. Ai ka thënë se struktura e LDK-së në Prishtinë

po vjen si forcë prijëse për shumë vjet. "Të faleminderit Prishtinë për pjesëmarrje impulsive nëpër çdo nëndegë. Përveçse mbështetje, po na jep edhe shpresë. Këtë vikend vazhduam me 4 kuvende të

tjera. Si në lagje të reja, sikurse Prishtina e Re III, ashtu dhe në fshatra të kryeqytetit - Shkabaj, Mramor e Keçekollë - pjesëmarrja qytetare është shenjë konfirmuese për 'Rrugën e Re'. Do të vazhdojmë

kështu dhe më shumë. E ardhmja është e ndritshme. Struktura e Lidhjes në Kryeqytet po vjen si forcë prijëse për shumë vjet", ka shkruar Abdixhiku në "Facebook".



286 të ikur për gjashtë muaj, "të rinjtë po bëhen infermierë për të dalë jashtë vendit"

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Kryetarja e Odës së Infermierëve të Kosovës (OIK), Nexhmije Gori, ka treguar se vetëm gjatë gjashtëmuajorit të parë të këtij viti Oda ka lëshuar 286 licenca - certifikata për infermierë, të cilat u shërbejnë atyre për punë jashtë vendit. Sipas Gorit, numri i infermierëve që po e lënë vendin është rritur shumë, veçanërisht në dy vitet e fundit, e nëse vazhdohet me këtë trend, vendi rrezikon të mbesë pa infermierë. Madje ajo ka thënë se shumë të rinj kalojnë posaçërisht në infermieri, nga një profesion tjetër, si rruga më e shpejtë e tyre për të ikur nga vendi.

E për ta ndalur një fenomen të tillë, Gori ka thënë se duhet të rriten pagat dhe të përmirësohen kushtet e punës së këtij profesioni, të cilin ajo e konsideron shumë të rëndësishëm sepse "janë infermierët ata që rrinë 24 orë me pacientët".

Ajo ka pasur kritika edhe për Ligjin e ri të Pagave, ngaqë ka pranuar shumë ankesa nga infermierët për këtë ligj, sidomos për pagat e ulëta dhe mospagesën e kujdestarive të natës, e cila u paguhet profesionistëve të tjerë shëndetësorë. "Emigrimi është në trend dhe infermierët çdo ditë e më shumë po kërkojnë licenca të paplasitifikuar dhe vërtetim të



kodit etik për t'u punësuar në vendet e tjera. Migrimi ka filluar, sipas statistikave tona, që nga viti 2019, me një fluks më të vogël. Ka pasur rritje vit pas viti, por përmasa të mëdha ka marrë në vitin 2022 dhe 2023. Këtë vit kemi lëshuar 286 licenca për gjashtëmuajorit e parë. Kjo e jep një numër të qartë për të gjithë infermierët të cilët e kanë lëshuar vendin", ka thënë ajo, duke shtuar se shumë të rinj po e ndërrojnë profesionin dhe po kalojnë në infermieri "sepse e kanë gjetur këtë si rrugën më të shkurtër për të mbërritur deri në vendet e rajonit apo dhe më gjerë". "Trendi

qysh ka filluar dhe po vazhdon, në një të ardhme të afërt, vendi ynë do të ketë mungesa për kuadro të tilla. Shpresoj që të bëhet një zgjidhje", ka thënë Gori.

Gori ka thënë se me Ligjin e Pagave kanë pritur që infermierëve t'u rriten pagat, të kategorizohen "aty ku e meritojnë" dhe t'u paguhet ndërrimet e natës. Ajo ka thënë se po presin ndryshime në këtë ligj e se me ngritjen e çmimeve, pagat e infermierëve janë shumë të ulëta. "Sa i përket Ligjit të Pagave, pritshmëria ka qenë shumë më e madhe dhe çdo ditë e më shumë ka pasur ankesa. Jemi duke pritur

ndonjë ndryshim. Kemi pritur që edhe infermierët të kenë një pagë dinjitoze dhe t'u bëhet rangimi aty ku e meritojnë ata ngase profesioni i infermierit nuk është vetëm profesion, por është një mision - janë ata të cilët kanë kontakte 24 orë me pacientin. Pagesat nuk janë të dinjitetshme. Nuk ka fare ngritje. Kur flasim për ndërrimet e natës, ato nuk kanë lëvizur. Me ndërrimin e kontratës kolektive është larguar edhe shujta, që në fund i bie se ata paguhet njëjtë si para sipas Ligjit të Pagave", ka thënë ajo për "EO". Këto ankesa kryetarja e OIK-ut ka thënë se janë drejtuar në organet kompetente, por nuk kanë marrë ende përgjigje. "Ne i kemi drejtuar ankesat e infermierëve në organet kompetente, por nuk kemi marrë ndonjë përgjigje. Mekanizmi kryesor për ta ulur largimin e infermierëve është hapja e vendeve të punës, përmirësimi i kushteve, përmirësimi i koeficientit për rritje të pagave. Siç po shihet fluksi, rreziku është i lartë që të mbesim pa infermierë. Mos të them që do të mbesim fare pa infermierë, por do të mbesim keq", është shprehur ajo.

Ndërsa duke folur për bashkëpunimin me Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK), ajo ka thënë

se kanë marrë premtimin se shumë shpejt do të hapet zyra e infermierëve në QKUK e cila është mbyllur.

Për ankesat e infermierëve ka folur edhe Leonora Bakija, nënkryetare e OIK-ut dhe kryeinfermiere e QKMF-së në Gjakovë. Ajo ka thënë se ankesat kryesore të infermierëve janë kategorizimi jo i drejtë në Ligjin e ri të Pagave, pagesa e kujdestarive, pagesa e punës në terren dhe për punët me ndjeshmëri më të lartë.

Bakija ka thënë se infermierët janë të diskriminuar nga pagat e kujdestarive në krahasim me profesionistët e tjerë shëndetësorë të cilëve u paguhet kujdestaria. "Infermierët janë të diskriminuar nga pagat e kujdestarive në krahasim me profesionistët e tjerë shëndetësorë. Si shembull, në institucione shëndetësore ata punojnë si ekip, mjeku paguhet me përqindje më të lartë, ndërsa infermieri nuk paguhet. Gjithashtu, puna në terren është e rëndësishme të paguhet dhe punët më të ndjeshme, siç janë intenziva dhe rrezikshmëria në punë, as ato nuk paguhet. Kështu që Oda vazhdimisht bën ankesa dhe kërkesa për rregullimin e këtyre çështjeve", ka thënë Bakija.

Nis ndërtimi i memorialit në vendin ku është bërë dalja publike e UÇK-së në Llaushë të Skenderajt



SKENDERAJT, 17 SHTATOR - Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, ka njoftuar se është vënë gurthemeli për ndërtimin e memorialit të daljes publike të UÇK-së në Llaushë të Skenderajt. "Bashkë me nënkryetarin gjeneral Sami Lushtaku, komandantin Jetullah Geci, deputetë të Parlamentit të Kosovës, ish-luftëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, familjet e dëshmorëve, invalidët dhe bashkëqytetarët,

vumë gurthemelin e ndërtimit të një vepre monumentale të kujtimit të pavdekshëm dhe nderimit të përgjeshëm të çastit më historik të daljes publike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Llaushë më 28 nëntor 1997. Mirënjohje e përgjeshme për UÇK-në!", ka shkruar Nura në "Facebook".

Mujë Krasniqi, Daut Haradinaj dhe Rexhep Selimi, më 28 nëntor të vitit 1997, në Llaushë të

Skenderajt, në varrimin e mësuesit Halit Geci, kishin dalë për herë të parë para opinionit publik si pjesëtarë të UÇK-së. Kësaj dalje i paraprijnë luftimet e para frontale ndërmjet UÇK-së dhe policisë serbe të drejtuara nga ish-komandanti Adem Jashari. Më 25 nëntor 1997 forcat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të drejtuara nga ish-komandanti Adem Jashari, sulmuan forcat e policisë në Vojnik të Skenderajt, të

cilat ishin tërhequr duke lënë të vrarë dhe të plagosur. Të nesërmen, më 26 nëntor, një ekspeditë ndëshkimore me 10 automobila e mjete të tjera të motorizuara ishin drejtuar për në këtë fshat, ku UÇK prapë i kishte sulmuar dhe pas katër orë luftimesh të rrepta, forcat e policisë ishin tërhequr duke lënë prapa të vrarë dhe të vdekur. Në tërheqje e sipër, forcat serbe, të egërsuara nga goditjet që ua

kishte dhënë UÇK, kishin qëlluar pa mëshirë kundër kujtoda që shihnin dhe në fshatin Llaushë kanë vrarë mësuesin Halit Geci në derë të shkollës, i cili është varrosur me një ceremoni të madhe më 28 nëntor 1997. Po ashtu, atë ditë ishte plagosur edhe mësuesi Shaban Rreci. Në këtë ceremoni varrimi, ku kanë marrë pjesë dhjetëra-mijëra qytetarë nga mbarë Kosova, është bërë dalja e parë publike e UÇK-së.



Haradinaj kërkon nga policia të jetë e pakompromis ndaj atyre që shkelin rregullat e komunikacionit

PRISHTINË, 17 NËNTOR - Të shtunën në Kosovë kanë ndodhur tri aksidente të cilat ishin fatale për jetën e pesë personave. Lidhur me këtë situatë ka reaguar lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj. Ai ka kërkuar nga pjesëmarrësit në komunikacion që të kenë

kujdes të shtuar, derisa i ka bërë thirrje policisë të jetë e pakompromis ndaj atyre që shkelin rregullat. "Mos e humbni jetën dhe mos i merrni jetën askujt në komunikacion. Me shqetësim dhe dhimbje të thellë po i përcjell lajmet për tragjeditë

në komunikacion, të cilat rezultuan me humbje jete, fatkeqësisht. Apeloj te çdo pjesëmarrës në komunikacion për kujdes të shtuar dhe respektim të rregullave. Nuk është vetëm jeta juaj në lojë, por edhe jeta e të tjerëve! Apeloj Policinë e Kosovës të

jetë vigjilente dhe e pakompromis ndaj atyre që shkelin rregullat e komunikacionit dhe sigurinë. Bashkëndiejmë me familjet e viktimave. Lutemi për shërim sa më të shpejt të të lënduarve!", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".



Avokatët i quajnë të padrejta dhe për spektakël bastisjet e Speciales: Po përpiqen ta mbajnë situatën e tensionuar

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Avokatët në Kosovë i kanë quajtur të padrejta dhe më shumë për spektakël bastisjet e fundit nga ana e EULEX-it në shtëpitë e familjarëve të ish-pjesëtarëve të UÇK-së. Arsye, sipas tyre, janë pretendimet për të gjetur gjurmë të reja që ndikojnë në gjykim dhe në dëshmitarë. Avokati Tomë Gashi ka thënë se formimi i Gjykatës Speciale nuk do të duhej të lejohej që nga fillimi. Sipas tij, kjo fuqi ekzekutive i është dhënë Gjykatës Speciale nga vetë Kosova e derisa të kemi një gjykatë të tillë do të kemi edhe njësi policore të EULEX-it në vend. "Kemi pasur disa bastisje dhe së paku në tri raste, ish-pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që kanë afërsi me ata që, fatkeqësisht, janë duke u gjykuar në Hagë, janë marrë në intervistim nga ana e EULEX-it dhe u janë konfiskuar telefonat. Mendoj që është fare e qetë, ata po pretendojnë se mund të gjejnë gjurmë të ndikimit në gjykime apo të ndikimit në dëshmitarë, respektivisht çështjeve të cilat janë të ndaluara, sipas tyre, që është pengim i drejtësisë", ka thënë Gashi për "Ekonomia Online".

Ai ka thënë se duhen pritur rezultatet e ekspertizës, për të parë se çfarë kanë gjetur nga këto konfiskime, në mënyrë që të komentohen bastisjet. "Do të bëhen ekspertiza se a po gjejnë fakte apo jo për çështje që ata pretendojnë se janë të ndaluara. Kjo situatë më së shumti është shprehur kinse nën ndikim të gjykimeve që po bëhen në Hagë, për të cilat nuk mund të flasim



derisa t'i shohim rezultatet, se çfarë do të gjejë ekspertiza në lidhje me konfiskimin e këtyre telefonave dhe pajisjeve të tjera. Këto bastisje nuk janë të drejta, por ne ia kemi dhënë një fuqi me votimin e Gjykatës Speciale në gusht të vitit 2015. Kanë kaluar më shumë se tetë vjet dhe jemi në një situatë ku i kemi dhënë fuqi ekzekutive Gjykatës Speciale dhe ajo përmes pjesëtarëve të policisë së EULEX-it po kryen çështje ekzekutive, të cilat më herët nuk kanë ndodhur. Derisa të kemi Gjykatë Speciale, do të kemi edhe njësi të policisë së EULEX-it në Kosovë", ka thënë Gashi.

I pyetur nëse këto bastisje po bëhen në mungesë të provave në Hagë, sipas deklaratave të disa analistëve vendas, Gashi ka thënë se ato janë konotacione politike e se askush nuk i di të gjitha provat që i ka prokuroria. "Nuk mund të

themi se çfarë prova ka Prokuroria Speciale në Hagë sepse askush nuk i di, përveç çështjeve të cilat ata i kanë bërë publike. Prokuroria e ka rolin kryesor që t'i paraqesë provat e saj. Janë më shumë konotacione politike. Secili që e thotë këtë duhet të ketë një bazë. Megjithatë, deklaratimet janë të lira sepse ne jemi shtet demokratik. Por duhet të themi se fatkeqësia është që nga votimi i Gjykatës Speciale kur e kemi deleguar një pjesë të sovranitetit juridik në Hagë, në një shtet krejtësisht tjetër", ka thënë ai.

Deputetët e Kosovës, siç ka thënë Gashi, kanë votuar për një gjykatë pa ditur mirë se çfarë përmban ajo, e cila, sipas tij është një gjykatë "antikombëtare, antishqiptare, antiKosovë dhe antiUÇK".

"Është ironike, disa nga deputetët e Kosovës që e kanë votuar atë, thuajse nuk e kanë ditur se çfarë

po votojnë dhe tani kanë kundërshtime me gjykimet që po mbahen atje. Duhej ta dinim në atë kohë dhe mos ta lejonim formimin e Gjykatës Speciale, e cila në prizmin tim është antikombëtare, sepse kemi së paku edhe një person i cili po kërkohet nga Shqipëria, që është arrestuar që më shumë se një muaj e gjysmë dhe i cili po kërkohet të transferohet në Hagë. Pra, kemi një gjykatë antikombëtare, antishqiptare, anti-Kosovë dhe anti-UÇK", ka thënë Gashi.

Ndërsa avokati Ardian Bajraktari ka thënë se këto bastisje janë si rezultat i disfatës që Zyra e Prokurorit të Specializuar në Hagë është duke marrë nga mbrojtja e liderëve të UÇK-së.

Më tutje, ai i ka quajtur spektakël dhe tendencë për ta mbajtur situatën e tensionuar në raport

me Gjykatën Speciale. "Sa i përket çështjes së veprimeve të fundit të Dhomave të Specializuara, natyrisht që ato rezultojnë spektakle të ndodhura në disfatë të vazhdueshme në procesin gjyqësor i cili po zhvillohet atje. Duhet të keni parasysh faktin që deri tash të gjithë dëshmitarët që janë dëgjuar e propozuar nga ana e prokurorisë dhe në këtë drejtim si rezultat i përgatitjes së mirë të palës mbrojtëse, kanë arritur t'i 'shpartallojnë' raportimet e mekanizmave ndërkombëtarë kryesisht të ardhur si rezultat i raporteve të Qeverisë së Serbisë. Andaj veprime të tilla janë tendencë për ta mbajtur situatën të tensionuar në raport me Dhomat e Specializuara, ndryshe janë veprime normale procedurale", ka thënë Bajraktari. Lidhur me këto bastisje, më 15 shtator kanë protestuar edhe organizatat e dala nga lufta e UÇK-së. Brenda një jave, me urdhër të ZPS-së, EULEX-i ka bastisur banesën e familjes së heronjve Fahri dhe Bahri Fazliu, shtëpinë e ish-bashkëluftëtarit të Salih Mustafës-Calit, Behar Berisha, ka ndaluar Rrustem Mustafën-Remin dhe Nait Hasanin. Gjatë këtyre aksioneve, EULEX-i ua ka konfiskuar telefonat familjarëve të heronjve Fazliu, Remit, Nait Hasanit dhe vëllait të dëshmorit Hakif Zejnullahut, Bajramit. Krejt këto bastisje dhe ndalime janë duke ndodhur në kohën kur është duke u zhvilluar procesi gjyqësor në Hagë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

Specialja ua vazhdon paraburgimin Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

HAGË, 17 SHTATOR - Fillimi i nëntorit do ta shënojë përvjetorin e tretë të arrestimit të katër prej udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. E kur kjo kohë po afrohet, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit i është vazhduar sërish paraburgimi nga Gjykata Speciale. Më rreziku i ikjes për katër ish-krerët e UÇK-së në Hagë nuk ekziston. Këtë e ka

konstatuar edhe trupi gjyqësor. Por, pavarësisht se prokurorisë i është rrëzuar ky argument, paraburgimi si masë po vazhdon të mbetet në fuqi. Rexhep Selimit e Jakup Krasniqit së fundmi i është vazhduar sërish masa e paraburgimit. Kjo është bërë me dije me anë të një vendimi të Gjykatës Speciale. Në mesin e arsyeve që trupi gjyqësor e ka vlerësuar si vendimtare për t'ua vazhduar paraburgimin Selimit dhe Krasniqit ka qenë

reziku për dëmtimin e provave, ndikimit në dëshmitarë dhe fuqia e tyre politike në Kosovë. Trupi gjyqësor në një pjesë të vendimit duket të jetë i vetëdijshëm për kohën e gjatë që Selimi dhe Krasniqi kanë kaluar në paraburgim. Andaj, kanë theksuar se do të kërkohen që gjykimi të zhvillohet sa më shpejt që të jetë e mundur. Deri më tash në gjykimin e krerëve të UÇK-së janë dëgjuar 25 dëshmitarë.



Dyqanet ngatërrojnë origjinën e produkteve

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Flamuri i Kroacisë nën produktin me origjinë nga Kosova. Ai i Kosovës nën produktin me origjinë nga Serbia. Shumë flamuj me ngjyra bardh e zi. Vende-vende nuk ka fare. Kështu duken raftet e disa dyqaneve ushqimore në Kosovë, edhe pse me rregulla, produktet duhet ta kenë vendosur pranë flamurit e vendit prej nga vijnë. Udhëzimi administrativ, i cili e rregullon këtë çështje, ka hyrë në fuqi në vitin 2019. Sipas tij, flamuri i origjinës së produktit duhet të jetë i vendosur në mënyrë të qartë dhe të jetë gjithëherë i dukshëm për konsumatorin. Në disa dyqane që ka vizituar "Radio Evropa e Lirë" në Prishtinë, ka vërejtur se ky udhëzim administrativ nuk zbatohet siç duhet. Këtë e ka konfirmuar edhe Inspektorati i Tregut në Ministrinë e Tregtisë, Industrisë dhe Ndërmarrësisë së Kosovës, i cili ka shqiptuar disa gjopa për këto shkelje.

Dhjetëra gjopa

Zëvendësi i kryeinspektorit të këtij inspektorati, Naim Hajra, ka thënë për "Radio Evropa e Lirë" se gjatë vitit të kaluar deri më tash këtë vit, janë shqiptuar 41 gjopa për mosvendosjen e flamurit të origjinës nën produkt, ndërsa janë pranuar 65 ankesa nga konsumatorët.

Në bazë të Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit, Hajra thotë se bizneset që nuk e respektojnë udhëzimin administrativ në fjalë, përfshirë mosvendosjen e saktë të flamurit të origjinës së produktit, gjobiten me nga 400 deri në 20 000 euro.

Sipas tij, rasti kur flamuri nuk korrespondon me origjinën e vërtetë të produktit është "mashtim".

Hajra ka supozuar se numri real i shkeljeve është shumë më i lartë, por se numri i inspektorëve që do t'i verifikonin ato, është shumë i vogël në raport me mijëra bizneset.

"Fatkeqësisht, Inspektorati i Tregut ka aktualisht vetëm tre inspektorë, të cilët merren me kontrollimin e vendosjes ose jo të flamujve të origjinës (së produktit)", ka thënë Hajra. Përfaqësues të dy kompanive në Kosovë, "Interex" dhe "VivaFreshStore", në dyqanet e të cilave vërehen ngatërresa me flamuj të origjinës së produktit, nuk i janë përgjigjur interesimit të "Radios Evropa e Lirë" se përse ndodh kjo.

Përfaqësues të bizneseve thonë se udhëzimi administrativ për këtë çështje, është vështirë të zbatohet, por kanë theksuar se është i rëndësishëm. "Ky vendim është ngarkesë shtesë për bizneset e Kosovës. Dyqanet e mëdha kanë numër të madh të stafit që mund të kujdeset për vendosjen e flamujve, por kanë edhe qarkullim të madh të



produkteve dhe nganjëherë mallrat zhvendosen nga rafti në raft... Mund të ketë edhe gabime që ndodhin", ka thënë Zana Beqiri nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë në Prishtinë.

Udhëzimi administrativ për origjinën e produkteve ka hyrë në fuqi para më shumë se katër vjetësh - përkatësisht pak kohë pasi Kosova u ka vënë taksë 100% produkteve me origjinë nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina.

Taksa është ndërmarrë si kundërpërgjigje ndaj politikave të këtyre dy vendeve kundër shtetësisë së Kosovës dhe anëtarësimit të saj në mekanizma dhe organizata ndërkombëtare.

Autoritetet e Kosovës kanë thënë atëkohë se ky udhëzim administrativ do t'i ndihmojë qytetarët t'i identifikojnë produktet me origjinë nga

Serbia dhe Bosnje e Hercegovina dhe do të ndikojë në promovimin e produkteve vendore.

"Pazari im ndikohet nga flamujt"

Disa qytetarë me të cilët ka biseduar "Radio Evropa e Lirë" në Prishtinë, thonë se kanë hasur në produkte që nuk përkojnë me flamurin e origjinës që u është vendosur pranë. "Për mua ka shumë rëndësi vendosja e famujve të origjinës. I shikoj flamujt dhe e di prej nga e ka origjinën ai produkt. I blej produktet gjermane, angleze dhe ato vendore. Kur është flamuri i Serbisë, nuk e blej", ka thënë Hysnije Mulaj.

Edhe Yll Rakovica ka thënë se i kushton rëndësi origjinës së produkteve ushqimore. "I shikoj

flamujt dhe pazari im ndikohet nga flamujt. Preferoj të blej prodhim vendor ose prodhim kualitativ, dhe jo të Serbisë. Por, ndodh shpesh që flamujt i vendosin gabim", ka thënë Yll Rakovica.

Serbia, deri vonë, ka qenë ndër shtetet me praninë më të madhe të produkteve të veta në Kosovë.

Nga viti 2018 deri në prill të këtij viti, Serbia ka eksportuar produkte në Kosovë në vlerë prej mbi 1.3 miliard eurosh.

Por, Qeveria e Kosovës i ka ndaluar pothuajse të gjitha importet nga Serbia qysh më 15 qershor, kur forcat serbe kanë arrestuar tre policë të Kosovës. Kosova importon shumicën e mallrave nga vendet fqinje, por edhe ato të BE-së, pasi industria e prodhimit nuk është shumë e zhvilluar.

Mesatarisht në vit, Kosova importon mallra nga vendet e ndryshme të botës në vlerë prej 5 miliardë eurosh, ndërsa eksportin vlerën e më pak se 1 miliard eurove.

Marrëveshja e Organizatës Botërore të Tregtisë, ku Kosova synon të anëtarësohet, kërkon nga anëtarët e OBT-së që t'i zbatojnë rregullat e tyre të origjinës së produkteve në mënyrë të paanshme, transparente dhe të qëndrueshme. Marrëveshja kërkon gjithashtu që rregullat e origjinës të mos e kufizojnë, shtrembërojnë ose prishin tregtinë ndërkombëtare.

Ekonomia e Kosovës shënon rritje vetëm 2.02 për qind, opozita me akuza për pushtetin

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Prodhimi i Brendshëm (PBB) së Kosovës ka shënuar rritje reale për 2.02 për qind në tremujorin e dytë të këtij viti.

Kështu ka bërë me dije Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), duke shtuar se rënia e eksporteve të mallrave kanë shënuar rënie për rreth 11 për qind.

"PBB-ja në tremujorin e dytë 2023 shënon rritje reale për 2.02 për qind, krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak". "Komponentët e PBB-së sipas metodës së shpenzimeve që kishin rritje ishin eksporti i shërbimeve me 13.62 për qind, importi i mallrave dhe shërbimeve me 6.29 për qind, shpenzimet e konsumit final të



Qeverisë me 3.96 për qind, shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake me 3.68 për qind dhe formimi i bruto kapitalit me 2.04 për qind. Ndërsa, rënie kishte eksporti i mallrave me 10.67 për qind", ka njoftuar ASK-ja.

Pas publikimit të këtyre të dhënave, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) kanë kritikuar qeverinë Kurti për

këtë normë, siç e kanë quajtur ata, të ulët ekonomike.

Sipas tyre, kjo rritje e ulët ekonomike po e degradon çdo ditë e më tepër standardin e jetës së qytetarëve në vend.

Koordinatori i Departamentit për Financa në Kabinetin për Qeverisje të Mirë në PDK, Arben Mustafa ka thënë se kjo është norma më e ulët e rritjes ekonomike në dhjetë vitet e fundit. "Të dhënat e publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës tregojnë se norma reale e rritjes ekonomike në tremujorin e dytë të vitit 2023 ishte vetëm 2.02 për qind - norma më e ulët e rritjes në dhjetë vitet e fundit", ka shkruar Mustafa në "Facebook".

Më tutje, ai është shprehur se kjo normë kaq e ulët e rritjes ekonomike kryesisht reflekton kushtet e vështira nëpër të cilat po kalon sektori privat.

"Këto të dhëna tregojnë se kah po shkon ekonomia e vendit dhe me këtë edhe standardi i jetesës së qytetarëve të Kosovës që po degradon çdo ditë e më tepër. Drejtimi që ka marrë ekonomia e vendit që nga ardhja në pushtet e Albin Kurtit ilustrohet qartë nga figura në vijim", ka shkruar ai. Ndërsa deputetja e LDK-së, Hykmete Bajrami, ka potencuar se rritja ekonomike në vend është më e ulët ndonjëherë.

Bajrami në një postim në "Facebook" ka shkruar se nuk ka dialog me biznese, 42 për qind e

buxhetit shkon në subvencione, ndërkaq janë bllokuar investimet kapitale. "Që 80 ditë vendin e kemi nën sanksione, që tri vite i kanë bllokuar investimet kapitale, nuk ka asnjë politikë fiskale, asnjë reformë për përmirësim të ambientit të biznesit, nuk ka rritje të pagave, 42 për qind e buxhetit shkon në subvencione, vetëm 18 për qind në investime kapitale që nuk arrijnë t'i shpenzojnë, nuk ka bashkëpunim me komuna, nuk ka dialog me biznese, ka korrupsion, ka nepotizëm dhe ka tenderë me negociim. Dhe ja rezultati 2.02 për qind rritja ekonomike për tremujorin e dytë 2023, më e ulët ndonjëherë", ka shkruar Bajrami.

OEGJK-ja dhe ITP-ja bëhen bashkë për tërheqjen e bizneseve gjermane në Kosovë

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare (OEGJK) dhe Parku i Inovacionit dhe Trajnimeve në Prizren (ITP) kanë filluar të intensifikojnë përpjekjet e përbashkëta në tërheqjen e bizneseve gjermane në vend dhe të lehtësojnë promovimin e eksportit për kompanitë ven-

dore përmes ofrimit të shërbimeve të ndërsjella.

Me këtë rast, drejtoresha e OEGJK-së, Nora Hasani dhe përfaqësuesi i autorizuar i ITP Prizren, Muhamed Rexhepi, kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi.

"Shërbimi Soft-Landing, që synon të tërheqë bizneset gjer-

mane në ITP dhe të lehtësojë integrimin e tyre, dhe Shërbimi Go-Global, i cili mundëson eksportimin e bizneseve anëtare të ITP në Gjermani", ka njoftuar OEGJK-ja.

Më tutje është bërë me dije se bashkëpunimi ndërmjet OEGJK-së dhe ITP-së do të marrë në konsideratë



aktivitetet e përbashkëta promovuese për hulumtimin, komercializimin dhe ndërmarr-

rësinë, pjesëmarrjen në programe dhe projekte vendore e ndërkombëtare në inovacion, teknologji, ndërmarrësi, hulumtim dhe zhvillim, shkëmbimin e njohurive, ekspertizën, mentorimin dhe trajnimet profesionale të stafit dhe ndarjes së praktikave të mira.

Pyetja e vërtetë që duhet të bëjmë për rritjen ekonomike

Mariana MAZZUCATO

Nga debatet e politikave të nivelit të lartë dhe manifestet politike deri te lajmet e përditshme, ankthi për rritjen ekonomike është kudo. Në Gjermani, buxheti i fundit i qeverisë identifikon rritjen më të fortë si një prioritet kryesor. Në Indi, udhëheqësit janë të etur për të rimarrë vendin si ekonomia me rritjen më të shpejtë në botë. Në Kinë, ku prespektiva e deflacionit është shfaqur në horizont, qeveria është e shqetësuar për arritjen e objektivit të saj, për një rritje ekonomike prej 5% për këtë vit. Në Mbretërinë e Bashkuar, Keir Starmer, kreu i Partisë Laburiste në opozitë, është zotuar të sigurojë rritjen më të lartë të qëndrueshme në G7 nëse merr pushtet, dhe konservatorët në pushtet shprehin ambicie të ngjashme (kujtoni mantrën e ish-kryeministres Liz Truss: "rritje, rritje dhe rritje").

Por vendosja e rritjes ekonomike në qendër të politikëbërjes është gabim. Edhe pse e rëndësishme, rritja në abstrakt nuk është një qëllim apo mision koherent. Përpara se të angazhohen për objektiva të veçantë (qoftë rritja e PBB-së, prodhimi i përgjithshëm e kështu me radhë), qeveritë duhet të fokusohen në drejtimin që duhet të marrë ekonomia. Në fund të fundit, çfarë dobie ka një rritje ekonomike e lartë, nëse arritja e saj kërkon kushte të këqija pune apo një industri në zgjerim të lëndëve djegëse fosile?

Për më tepër, qeveritë kanë qenë më të suksesshme në katalizimin e rritjes ekonomike, kur kanë ndjekur qëllime të tjera – duke mos e trajtuar rritjen si objektiv në vetvete. Misioni i NASA-s për të dërguar një njeri në Hënë (dhe për ta rikthyer shëndoshë e mirë) solli risi në hapësirën ajrore, materiale, në elektronikë, ushqim dhe softuerë, që më vonë do të sillnin vlerë të shtuar të konsiderueshme, ekonomike dhe tregtare. Por NASA nuk u nis për të krijuar këto teknologji, dhe për këtë arsye, ndoshta nuk do t'i kishte zhvilluar kurrë ato nëse misioni i saj do të kishte qenë thjesht për të rritur prodhimin.

Njësoj me këtë, interneti erdhi e u shfaq nga nevoja për të bërë që satelitët të komunikonin me njëri-tjetrin. Për shkak të adoptimit të gjerë të tij, PBB-ja dixhitale është rritur 2.5 herë më shpejt se PBB-ja fizike gjatë



dekadës së kaluar dhe tani ekonomia dixhitale është në rrugën e duhur për të arritur vlerën e 20.8 trilion dollarëve, deri në vitin 2025. Sërish, shifra të tilla rritjeje ekonomike janë rezultat i angazhimit me mundësitë që ofron dixhitalizimi; rritja ekonomike në vetvete nuk ishte qëllimi.

Në vend që të fokusohen në përshejtimin e rritjes së PBB-së dixhitale, qeveritë duhet të synojnë ngushtimin e hendekut dixhital dhe të sigurojnë që rritja aktuale dhe e ardhshme të mos bazohet në abuzimin e kompanive të Big Tech, me fuqinë e tregut. Duke pasur parasysh se sa shpejt po përparon intelijenca artificiale, kemi nevojë urgjente për qeveri që mund të formësojnë revolucionin e ardhshëm teknologjik, në interes të publikut.

NXitja e rritjes ekonomike në një drejtim më gjithëpërfshirës do të thotë largim nga financimi i veprimtarisë ekonomike dhe riangazhim për investime në ekonominë reale. Siç janë gjërat, shumë kompani jofinanciare (përfshirë prodhuesit) po shpenzojnë më shumë për blerjen e aksioneve dhe pagesat e dividendëve, sesa për kapitalin njerëzor, makineritë dhe kërkimin e zhvillimin. Ndërsa aktivitete të tilla mund të rrisin çmimin e aksioneve të kompanive në afat të shkurtër, ato reduktojnë burimet e disponueshme për riinvestim të punëtorët, duke zgjeruar ndarjen midis atyre që kontrollojnë kapitalin dhe atyre që nuk e kontrollojnë.

Financializimi ka të bëjë më shpesh me nxjerrjen e vlerës dhe maksimizimin afatshkurtër të fitimit, sesa me krijimin e vlerës për hir të shoqërisë në tërësi. Për të arritur një rritje gjithëpërfshirëse, ne duhet të pranojmë se punëtorët janë krijuesit e vërtetë të vlerës dhe interesat e tyre duhet të jenë të zënë një vend parësor, në diskutimet rreth të ardhurave dhe shpërndarjes së pasurisë.

Në këtë kuptim, qëndrimi i ri i Partisë Laburiste të Mbretërisë së Bashkuar për të drejtat e punëtorëve është shqetësues. Në një përpjekje për të joshur drejtuesit e korporatave dhe për t'u dalë kundër pretendimeve se janë "anti-biznes", Laburistët e kanë zbutur angazhimin e tyre të shpallur më parë, për mbrojtje më të forta për punëtorët. Megjithatë, rritja ekonomike e udhëhequr nga investimet, dhe të drejtat e punëtorëve nuk duhet të konsiderohen si prioritet konkurrese. Ekuilibrimi i angazhimit të korporatës me një përkushtim ndaj punëtorëve nuk është vetëm thelbësor për arritjen e rritjes ekonomike gjithëpërfshirëse; tashmë është vërtetuar se nxit produktivitetin dhe rritjen në terma afatgjatë.

Ekonominë nuk do të rritet vetë, në një drejtim të dëshirueshëm shoqëror. Siç e theksova 10 vjet më parë, shteti ka një rol të rëndësishëm sipërmarrës për të luajtur. Pas përpjekjeve të fundit të qeverive për të ristartuar ekonominë e tyre pas pandemisë, është e qartë se kemi ende nevojë për një

mendim të ri se si të arrijmë një rritje ekonomike që nuk është vetëm "e zgjuar", por edhe e gjelbër dhe gjithëpërfshirëse.

Qeveritë kanë nevojë për udhërrëfyes të politikave ekonomike me qëllime të qarta, bazuar në atë që ka më shumë rëndësi për njerëzit dhe planetin. Mbështetja publike për bizneset duhet të kushtëzohet me investime të reja që do të "ndërtojnë më mirë të ardhmen" drejt një ekonomie reale më të gjelbër dhe më gjithëpërfshirëse. Kini parasysh Aktin e CHIPS dhe Shkencës të Shteteve të Bashkuara, i cili synon të stimulojë industrinë vendase të gjysmëpërçuesve. Ligji ndalon përdorimin e fondeve për kthimin e aksioneve dhe mund të imagjinohej kollaj dispozita shtesë, të cilat kërkojnë që fitimet e ardhshme të riinvestohen në trajnimin e fuqisë punëtore.

Por për ta çuar rritjen ekonomike në drejtimin e duhur, qeveritë duhet të bëjnë gjithashtu investime të orientuara drejt aftësive, mjeteve dhe institucioneve të tyre. Kontraktimi i jashtëm i kapaciteteve bazë ka dëmtuar aftësinë e tyre për t'u përgjigjur nevojave dhe kërkesave në ndryshim, duke reduktuar përfundimisht potencialin e tyre për të krijuar rritje të qëllimshme dhe vlerë publike. Edhe më keq, ndërsa aftësitë dhe ekspertiza e sektorit publik janë zbratur, ai është bërë më i ndjeshëm për t'u kapur nga interesa të fshehta.

Vetëm me kapacitetet dhe

kompetencat e duhura qeveritë mund të mobilizojnë me sukses burimet dhe të koordinojnë përpjekjet me bizneset që janë të gatshme të punojnë drejt qëllimeve të përbashkëta. Një strategji industriale e orientuar nga misioni kërkon që sektori publik dhe privat të punojnë së bashku në mënyrë simbiotike. E bërë siç duhet, një qasje e tillë mund të maksimizojë përfitimet publike afatgjata dhe vlerën e palëve të interesuara: rritja e udhëhequr nga inovacioni bëhet sinonim i rritjes gjithëpërfshirëse.

Pyetja që duhet të bëjmë nuk është se sa rritje mund të arrijmë, por të çfarë lloji. Për të arritur një prodhim më të madh ekonomik që është gjithashtu gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm, qeveritë do të duhet të përqafojnë potencialin e tyre për të qenë krijues të vlerave dhe forca të fuqishme që formësojnë ekonominë. Riorientimi i institucioneve publike rreth misioneve ambicioze – në vend të obsesionit pas objektivave të ngushta të rritjes ekonomike – do të na lejojë të përballemi me sfidat e mëdha të shekullit të 21-të dhe të sigurojmë që ekonomia të rritet në drejtimin e duhur.

Mariana Mazzucato, Drejtoreshë Themeluese e Institutit UCL për Inovacionin dhe Qëllimet Publike, është Kryetare e Këshillit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë për Ekonominë e Shëndetit për të Gjithë. / El Pais – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Trepça e fiton Superkupën në basketboll

SUHAREKË, 17 SHTATOR - Në Suharekë u zhvillua finalja e Superkupës së Kosovës mes Trepça dhe Pejës. Trepça ka fituar me rezultat 78:76. Sfida ishte e

tensionuar dhe ishte ndërprerë një minutë pa përfunduar pjesa e parë. Në pushim, Trepça ka shkuar me epërsinë prej 40:32. Ndonëse është tërhequr

vërejtja, fyerjet mes tifozëve dhe hedhjet në parket kanë vazhduar. Fillimisht trajneri Rami Hadar, e mori ekipin dhe u largua drejt zhveshtores. Teksa u kthye

më pas kur u qetësua situata. Megjithatë, gjyqtari i largoi sërisht dy ekipet derisa të zbrazet pjesa ku ishin tifozët mitrovicas, "Torcida".



Ballkani ndalet nga Dukagjini, Llapi merr kryesimin

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Skuadra kampione në futboll, Ballkani është njoftuar me barazim në këtë edicion garash, pasi nuk ka arritur të nxjerrë me shumë se një pikë nga përballja me Dukagjini (1-1). Dukagjini ishte dominuese në pjesën e parë dhe në fund të kësaj pjese shënoi golin e epërsinë nëpërmjet Altin Merlakut. Kampionët u angazhuan me shumë në pjesën e dytë dhe krejt çka arriti ishte goli i barazimit që e shënoi Albin Berisha, në minutën e 71-të. Ballkani ka një ndeshje me pak të zhvilluar dhe zë vendin e dytë në tabelë me 10 pikë, kurse Dukagjini është në pozitën e tetë me tri pikë. Baras ka përfunduar edhe ndeshja tjetër mes Prishtinës dhe Lirisë (1-1), e cila u zhvillua në

Kampin Nacional të FFK-së në Hajvali. Kryeqytetasit kaluan të parët në epërsi me golin e shënuar nga Leotrim Kryeziu (34'). Në pjesën e dytë ishte Liria që e dominoi lojën. Andri Stafa shënoi në minutën e 54-t, por goli nuk u pranua pas rishikimit në VAR. Mirëpo, goli i barazimit erdhi në minutën e 75-të, kur Prince Tjiueza shënoi nga afërsia. Prishtina e pati rastin të rikthen epërsinë, por gjuajtjen Leotrim Kryeziut nga pika e bardhë e ndali Arlis Shala. Të shtunën janë zhvilluar tri ndeshjet tjera në Superligë. Nënkampionia e Superligës, Drita ka shkëputur një pikë si mysafire e Fushë Kosovës, pasi ndeshja e zhvilluar në stadiumin "Sami Kelmendi" në Lipjan është mbyllur me rezultat 1-1. Drita e gjeti e para golin në minutën e 32-të përmes Blend Baftiut, mirëpo Fushë Kosova barazoi në minutën e 59-të me një gol



të Dominik Ivkiq, i cili u pranua pas rishikimit në VAR-it. Llapi arriti fitore me rezultat bindës, 3-0, ndaj Feronikelit '74 në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas. Golat për Llapin i shënuan Muhamet Hyseni, Ergyn Ahmeti dhe Trimror

Selimi. Pas kësaj ndeshje Llapi është i pari në tabelë me 10 pikë, kurse "Nikli" është në pozitën e parafundit me 3 pikë. Fitoren e parë në këtë edicion e ka realizuar Gjilani, që para tifozëve të vet ka arritur të mposhtë Malishevën, me rezultat 1-0.

SUPERLIGA - JAVA E PESTË

Dukagjini - Ballkani	1-1
Prishtina - Liria	1-1
Fushë Kosova - Drita	1-1
Feronikeli '74 - Llapi	0-3
Gjilani - Malisheva	1-0

TABELA

Pikë		
1. Llapi	5	10
2. Ballkani	3	10
3. Malisheva	4	9
4. Prishtina	4	9
5. Drita	3	6
6. Liria	4	6
7. Gjilani	3	4
8. Dukagjini	4	3
9. Feronikeli 74	4	3
10. Fushë Kosova	3	1

Golin e fitores për gjilanasit e shënoi Kushtrim Shabani, në minutën e 55-të.

Besa dhe Istogu fituese të Superkupës



PRISHTINË, 17 SHTATOR - Besa Famgas është fituese e Superkupës së Kosovës në hendboll për herë të dytë rresht. Kështu ekipi pejan ka shtuar edhe një trofe në koleksionin e pasur. Besa në ndeshjen për Superkupë e mposhti Trepçën me rezultat 36:28. Ndeshja u zhvillua të shtunën mbrëma në palestrën "Minatori" në Mitrovicë para një numri të madh shikuesish. Besa ishte vazhdimisht para për disa gola. Trepça megjithatë kërkoi barazimin

deri në fund dhe kështu ndeshja ishte e fortë dhe cilësore. Trofeun e Superkupës e dorëzoi presidenti i FHK-së, Eugen Saraçini. Medaljet për ekipin pejan i dorëzuan presidenti Saraçini dhe kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza. Ndërsa KHF Istogu e ka fituar Superkupën e Kosovës për herë të dytë. Në ndeshjen shumë të fortë, të shtunën mbrëma në Mitrovicë, Istogu e mposhti Ferizajn me rezultat 31:27. Istogaset ishin kohë të

gjatë në epërsi, por ferizajaset nuk janë dorëzuar deri në fund. Ndeshja ishte me ritëm të lartë, ndërsa shikuesit panë aksione e gola të bukur. Kapitenes së Istogut, Albina Rugova, trofeun e Superkupës ia dorëzoi presidenti i Federatës së Hendbollit të Kosovës, Eugen Saraçini. Medaljet i ndanë presidenti Saraçini dhe anëtari i bordit të FHK-së, Bujar Istrefi. Istogu ka vazhduar dominimin në hendbollin kosovar. Ka fituar trofeun e tretë të vitit.

Sainzi thyen dominimin e Verstappenit dhe Red Bullit

Marina Bay, 17 shtator - Piloti spanjoll i Ferrari, Carlos Sainz, fitoi garën e Cmimit të Madh të Singaporit në Formula 1, zhvilluar në pistën qytetase të Marina Bay. Një triumf i jashtëzakonshëm i "kokëkuqes", që rikthehet te fitorja pas më shumë se një viti, duke korrur suksesin e


parë sezonal dhe ndalur dominimin e Red Bull, që kishte fituar gjithnjë këtë vit. Sainz e nisi garën nga "pole position" dhe e ruajti atë vend deri në fund, pavarësisht sulmeve të rivalëve dhe strategjive të ndryshme të gomave që pilotët përdorën. Ky është sukseksi i dytë i Sainz

në karrierë. Në podium u ngjitën edhe Lando Norris me McLaren (i dyti) dhe Leëis Hamilton me Mercedes (i treti). Një garë mjaft e bukur dhe spektakolare, ku të gjitha makinat ishin pranë njëra-tjetrës, ndërkohë që zhgënjeu Red Bull, shumë larg pritshmërisë dhe podiumit.

Verstappen e mbylli garën në vendin e pestë, ndërsa Perez në të tetin, duke mos dueluar dot asnjëherë për fitoren. Fituesi mbeti i hapur deri në kthesën e fundit, pasi strategjithë e ndryshme të gomave bënë që pilotët të duelojnë fort për fitoren. Keqardhje për Russell, që




synonte podiumin e fitoren, por u përplas pak kthesa nga finishi i garës. Në vendin e katërt u klasifikua Charles Leclerc (Ferrari).



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica

NPL - "Qendra Multifunkionale" SH.A.



Bazuar në nenin 8 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik, Ndërmarrja Publike "Qendra Multifunkionale" SH.A. shpall:

K O N K U R S

Për plotësimin e vendit të lirë të punës

Titulli: Zyrtar/e i/e Prokurimit 1 (një pozitë)

Nr i referencës: 01/23
Lloji i pozitës: Zyrtar/e i/e Prokurimit
Orët e Punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja: Me kohë të pacaktuar (puna provuese 6 muaj), me mundësi vazhdimi
Selia: NPL "Qendra Multifunkionale" Sh.A.
Adresa: Rr. "Bedri Gjinaj" pn. Mitrovicë

Përgjegjësitë kryesore janë:

- ◇ Merret me hulumtimin, marrjen dhe pranimin e ofertave për kërkesat e Qendrës;
- ◇ Harton dosjet e tendereve dhe i bën të gatshme për publikim;
- ◇ Pregadit regjistrin e pranimin dhe dorëzimit të Ofertave;
- ◇ Pregadit dhe mban procesverbalin për hapjen dhe raportet e vlerësimit të ofertave;
- ◇ Regjistron dhe mban evidencë (në fletore dhe elektronike) për të gjitha prokurimet e inicuar;
- ◇ Lëndën e kompletin nga iniciimi i procedurës deri të nënshkrimi i kontratës dhe është përgjegjës për arkivimin e tyre;
- ◇ Pregadit njoftimet për kontratë;
- ◇ Nxjerr urdhërblert për lëndët, për të cilat autorizohet nga zyrtarët e ndërmarrjes dhe mban evidencë;
- ◇ Përgadit raport 3, 6 dhe 12 mujor për të gjitha prokurimet
- ◇ Mban përgjegjësi për të gjitha procedurat e prokurimit dhe mbarëvajtjes së procedurave;

Kualifikimet:

- ◇ Fakulteti ekonomik, juridik (bachelor, master e preferuar);
- ◇ Të ketë minimalisht 2 vite punë të ngjajshme përparësi në (Prokurim)
- ◇ Të ketë njohuri të mira të ligjeve në fushën prokurimit publik;
- ◇ Të ketë aftësi shumë të mira komunikuese dhe të menaxhimit të kohës.
- ◇ Të jetë në gjendje të punojë në presion dhe në bashkpunim me koleget tjerë.
- ◇ Të ketë njohuri shumë të mira për softweret: Microsoft Office- veqanerisht Word dhe Excel;
- ◇ Përparësi preferohet që kandidati të jetë i çertifikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik apo menaxhimin e kontratave.

Procedura e aplikimit:

- Aplikacioni për punë
- CV-ja
- Dëshmia mbi përgaditjen profesionale
- Çertifikata e lindjes (origjinal)
- Letërnjoftimi (kopje)
- Përvoja e punës nga lëmia profesionale (për pozitën që nevojiten)
- Çertifikatën nënhetime (jo më e vjetër se 6 muaj).

Data e Aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendariq nga dita e publikimit 18.09.2023 deri me 02.10.2023, që konsiderohet dita e fundit e mbylljes së konkursit.

Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatë:

Përmes e-mailit të Ndërmarrjes: qendraomnisport@gmail.com, dhe nr.telefonit.

Vërejtje:

I gjithë dokumentacioni merret në Administratën e NPL "Qendrës Multifunkionale" Sh.A. si dhe duhet të dorëzohet i mbyllur në zarf.


Aplikacionet dhe dokumentacionet e pakompletuara sipas kërkesave të përcaktuara në këtë shpallje, si dhe ato që arrijn pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.


Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen.

Vetëm kandidatët të cilët hyjnë në listën e ngushtë do të kontaktohen dhe ftohen për intervistë.

Datë: 18.09.2023
Ndërmarrjes
Mitrovicë

Organi kompetent i SH.A





Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook 

www.facebook.com/gjejpuneshpeite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Brikena Pira shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit "Bub", Sh.P.K, Ferizaj me numër: 810153456.

- Shkumbin Zherka nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Boro Vukmiroviq".

- Elmedina Habib Spahiu shpall të pavlefshme diplomën e Bachelorit në Banka, Financa dhe Kontabilitet në Kolegjin AAB me nr. 1190/15.

- Denat Memaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu "Dëshmorët e Zhurit" Zhur.

- Xhemal Sagdati shpall të pavlefshme 1 dëftesë si dhe diplomën Q.K "11 Marsi" Prizren.

- Elton Bytyqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme Ekonomike' Kadri Kusari".

- Adriana Xhema, shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme ekonomike "Hasan

Prishtina".

- Valmir Habibi, shpall te pavlefshme dëftesat e shkolles se mesme teknike "Arkitekt Sinani".

- Enesa Selmani, shpall te pavlefshme dëftesat e shkolles fillore "Shemi Ahmeti".

- Gresa Aliu, shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën e testit te maturës shkolla e mesme "Xheladin Deda".

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



ROYAL CROWN



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

